



09 QERSHOR 2017

## Kuotat për përfaqësimin gjinor në rregullat e zgjedhjeve të Kosovës

Nga Adrian H. Zeqiri

Në vështrimin e fundit për zgjedhjet e ardhshme, ECMI Kosova ka shqyrtuar, për më tepër, polemikat që kanë lindur rreth përfaqësimit gjinor dhe dispozitave ligjore që përpiqen të sigurojnë një nivel minimal të përfaqësimit të grave në procesin zgjedhor dhe në Kuvendin e ardhshëm të Republikës së Kosovës.

Kosova ka të vendosur një numër mekanizmesh që sigurojnë përfaqësimin e grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara në institucionet publike. Sipas kuadrit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës komunitetet pakicë përfitojnë nga një gamë e gjerë mekanizmesh që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre.<sup>1</sup> Çështjet e grave janë gjithashtu në thelbin apo në bërthamën e shumë dispozitave.

Në një deklaratë të lëshuar më 19 maj, 2017 Institucioni i Avokatit të Popullit ka shprehur pikëpamjen se, në bazë të Ligjit për barazi gjinore, *“ofrimi i mundësive të barabarta dhe pa diskriminim mbi çfarëdo baze”* është i detyrueshëm, ndërsa pritet që të gjitha *“subjektet politike që marrin pjesë në këto zgjedhje [...] të respektojnë parimin e barazisë, ku garantohet përfaqësimi prej 50% për secilën gjini”*.<sup>2</sup>

Për më tepër, Rrjeti i Grave të Kosovës ka lëshuar një deklaratë se të gjitha partitë politike, listat e të cilave nuk janë të ndara në mënyrë të barabartë në mes të kandidatëve meshkuj dhe femra kanë shkelur Ligjin për barazi gjinore dhe se KQZ-ja gjithashtu ka shkelur në fjalë *“duke mos kundërshtuar listat e paraqitura nga subjektet politike dhe [...] duke mos kërkuar*

<sup>1</sup> Për më shumë ju lutemi referojuni raporteve të përgatitura nga ECMI Kosova në dispozicion në:

<http://www.ecmikosovo.org/en/Kosovo's-Legal-Framework>,

<http://www.ecmikosovo.org/en/Institutional-Framework>,

<http://www.ecmikosovo.org/uploads/11.Kosovo%20snap%20elections%20background%20and%20predictions%20A%20Zeqiri.pdf> dhe <http://www.ecmikosovo.org/uploads/26English2.pdf>

<sup>2</sup> Deklarata e plotë e Institucionit të Avokatit të Popullit në dispozicion në:

<http://www.ombudpersonkosovo.org/en/news/OMBUDSPERSON%E2%80%99S-STATEMENT-CONCERNING-EQUAL-GENDER-REPRESENTATION-IN-CANDIDATES%E2%80%99-LIST-BY-POLITICAL-ENTITIES---1511>.

ndryshimin e tyre". Si reagim ndaj kësaj situatë, Rrjeti i Grave të Kosovës po u bën thirrje të gjithë qytetarëve që të votojnë për kandidatet femra.<sup>3</sup>

## Çfarë thotë Ligji për barazinë gjinore?

Neni 6 i Ligjit Nr 05/L-020 për Barazi gjinore, thotë se "Institucionet publike duhet të marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi" (paragrafi 1). Midis "masave të posaçme" të listuara në këtë nen janë "kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave" (paragrafi 2.1).

Neni 6 gjithashtu thekson se "organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet dhe institucionet e tjera publike janë të detyruara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të rritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave sipas këtij ligji" (paragrafi 7). Në vazhdim të këtij neni sqarohet se "Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha, organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur të sigurohet një përfaqësim minimal prej 50% për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse" (Paragrafi 8).

Për zgjedhjet dhe listat e kandidatëve, Neni 14 i Ligjit për barazi gjinore thotë se "Partitë politike me veprimet e tyre janë të detyruar të zbatojnë masa për të nxitur pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave në autoritetet dhe organet e partive në përputhje me dispozitat e nenit 6 të këtij të ligjit".

Me pak fjalë, Ligji për barazi gjinore, i cili u miratua në maj të vitit 2015, e obligon Kuvendin e Kosovës dhe partitë politike që të ndërmarrin masa për të siguruar përfaqësim 50-50. Megjithatë, ligji nuk specifikon se si duhet të bëhet apo të arrihet deri te ky përfaqësim. Me fjalë të tjera, ndërsa ligji ka vendosur një kërkesë ligjore, kjo kërkesë vlen për miratimin e masave të posaçme shtesë në të ardhmen.

Deri më sot nuk janë ndërmarrë veprime të tilla, kështu zgjedhjet vazhdojnë të mbahen dhe udhëhiqen sipas Ligjit Nr 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, të miratuar në vitin 2008, dhe ndryshim-plotësimeve të mëvonshme. Neni 27 i këtij ligji përcakton se "Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) janë femra, me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë".

Për më tepër, neni 111.6 i këtij ligji përcakton që të paktën 30% e deputetëve nga 100 vendet e ndara për partitë politike shqiptare duhet të jenë nga "gjinia pakicë brenda një subjekti politik". Kjo bëhet, së pari, duke ndarë numrin e përgjithshëm të vendeve në një subjekt politik dhe pastaj nëse 30% e kuotës për gjininë pakicë nuk arrihet, "kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë do të zëvendësohet nga kandidati tjetër i radhës i gjinisë tjetër në listën e ri-

<sup>3</sup> Deklarata e plotë e Rrjetit të Grave të Kosovës është në dispozicion në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20170607122826944.pdf>.

renditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë të paktën 30%". Efekti praktik i këtij rregulli është se, mesatarisht, një vend për një deputet mashkull fitohet me diku rreth 5000-7000 vota, ndërsa një vend për një deputete femër fitohet me rreth 3000-5000 vota. Kështu, po mos të ishte kjo dispozitë, përfaqësimi i grave në Kuvend do të ishte shumë më i ulët.

## **Si është balanca gjinore në listën aktuale të kandidatëve të partive dhe subjekteve politike?**

Nga 26 partitë dhe koalicionet që konkurrojnë në zgjedhjet e ardhshme, gjashtë nuk përmbushin minimumin e kërkuar prej 30% sipas Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Listat zyrtare të koalicionit LDK-AKR dhe partisë Vetëvendosjes janë secila 29% femra, ndërsa në koalicionin e madh të udhëhequr nga PDK dhe AAK, gratë përfaqësojnë vetëm 27% të kandidatëve. Partitë e tjera, listat e të cilave janë më pak se 30% femra janë Za Prosperitet Kosova (29%), Kosova Demokratik Türk Partisi (24%) dhe GI Eromendje Alternativa, tre kandidatët e së cilës janë që të gjithë meshkuj.

Vetëm dy parti (Građanska Inicijativa Srpska Lista dhe Partija Kosovskih Srba-Aktivna Gradjanska Inicijativa) kanë një shpërndarje të saktë gjinore 50-50 në listat e tyre, ndërsa në njërin parti (Pokret Za Gora) gratë janë të mbi-përfaqësuar, me pesë kandidate femra nga nëntë gjithsejtë.

Duke marrë parasysh të gjitha partitë dhe koalicionet së bashku, 322 nga 971 kandidatë, ose 33%, janë gra. Ngjashëm, mesatarja e kandidateve femra tek partitë dhe koalicionet garuese është 34%.

Kërkesat për listat e kandidatëve dhe shpërndarjen e vendeve në Kuvend janë të njëjta për partitë që përfaqësojnë komunitetet pakicë që konkurrojnë për 20 vendet e garantuara. Sidoqoftë, për shkak të numrit të vogël të vendeve të synuara, rregullat nuk mund të aplikohen gjithmonë si rregullat për partitë shqiptare. Në mënyrë të veçantë, rregulli për shpërndarjen e vendeve në kuvend mund të zbatohet për komunitetin serb, me 10 vende dhe për komunitetin boshnjak me 3 vende, por jo edhe komunitetet tjera, të cilët kanë vetëm 2 ose 1 vend të garantuar. Në zgjedhjet e vitit 2014, komuniteti pakicë me proporcionin më të lartë të deputetëve femra ishte komuniteti boshnjak, me dy deputete femra nga tre deputetë gjithsejtë. Komuniteti serb ishte gjithashtu mbi kuotën prej (30%), ku katër nga dhjetë vendet e tyre u kanë takuar deputeteve gra. Komuniteti turk kishte një përfaqësuese femër nga dy deputetë sa kishin gjithsejtë në Kuvendin e Kosovës. Pjesa tjetër e komuniteteve kishte vetëm nga një deputet, kështu që kuota prej 30% nuk mund të zbatohet nga këto komunitete, dhe në të gjitha këto raste deputeti ishte mashkull. Fakti që komunitetet serb, boshnjak dhe turk ishin në mënyrë të konsiderueshme të përfaqësuar mbi minimumin ligjor sugjerojnë se këto komunitete nuk kanë nevojë për kuotë gjinore.

## **Konkluzione**

Kosova ka vendosur rregullin që kërkon 30% të përfaqësimit të grave në listat e partive dhe në Kuvend që në vitin 2000, kur janë zhvilluar rregullat e reja zgjedhore nën administrimin e misionit të përkohshëm të OKB-së në bashkëpunim me përfaqësuesit e partive politike

kosovare dhe shoqërisë civile. Kjo më pas u vendos në kuadrin ligjor pasues të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas Deklaratës së Pavarësisë në vitin 2008. Siç kemi parë nga pesë-(5) legjislaturat e mëparshme, kuota prej 30% ka funksionuar në favor të grave. Ajo ka lejuar që shumë deputete femra të përfaqësohen në Kuvendin e Republikës, të cilat përndryshe do të mund të mos kishin qenë të zgjedhura për deputete.

Duke marrë parasysh baraspeshën gjinore në listat aktuale të partive dhe koalicioneve, nuk ka gjasa që pjesëmarrja e grave në Kuvendin e Republikës të kalojë ndjeshëm mbi një të tretën (1/3) e të gjithë deputeteve në zgjedhjet e ardhshme. Kjo do të thotë se duhet të bëhet përparim i konsiderueshëm në mënyrë që numri i deputeteve në Kuvendin e Republikës të jetë i barabartë siç përcaktohet me Ligjin për barazi gjinore dhe siç e ka shprehur Institucioni i Avokatit të Popullit në deklaratën e tyre për perspektiven gjinore.

Ekziston një debat i vazhdueshëm, në Kosovë dhe më gjerë, për meritat dhe efektivitetin e përdorimit të sistemit të kuotave për të siguruar përfaqësimin e grupeve të marginalizuara. Koalicioni ERAC beson fuqimisht se në një shoqëri ku gratë ende janë të strukturuar në mënyrë të pafavorshme, masa të veçanta siç janë kuotat janë një mekanizëm i përshtatshëm për të nxitur dhe promovuar pjesëmarrjen e grave në jetën publike. Kjo është në përputhje me rekomandimet dhe përfundimet e gjetura në Përmbledhjen e praktikave të mira të OSBE-së të vitit 2016 për Avancimin e pjesëmarrjes politike të grave në rajonin ku vepron OSBE-ja Planin strategjik të UN-Woman-it 2014-2017.

Në fund, ndërsa kërkesa për të lëvizur drejt përfaqësimit 50-50 është qartë e vendosur në Ligjin për barazinë gjinore, dispozitat e sakta ende nuk janë përfshirë në kuadrin aktual ligjor. Megjithatë, Koalicioni ERAC inkurajon partitë politike, shoqërinë civile dhe institucionet qeveritare që të punojnë së bashku për të përmbushur këto kërkesa ligjore në të ardhmen dhe të iniciojnë një proces të ndryshimit të ligjit për zgjedhjet për ta sjellë atë në përputhje me Ligjin për barazi gjinore.

## Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislationit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.